




Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	22.01.2016
REFERENC-Ë:	DPK-DPKPP 03-03/4495/15
PËR/ZA/TO:	z. Besar MAQEDONCI u.d. Shef i Prokurimit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
CC:	z. Albert AVDIU Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Shërbimet e përkthimit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme "

I nderuari z. Maqedonci ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Shërbimet e përkthimit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme " me numër prokurimi 33300-15-065-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Shërbimet e përkthimit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme " me numër prokurimi 33300-15-065-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 09.12.2015, ka nxjerr vendim me nr. protokoll *AKK-03-3-4495/15* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull “ **Shërbimet e përkthimit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme**“ me nr. të prokurimit **33300-15-065-221**, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me datë 09.12.2015, Agjencia ka paraqitur kërkesë për dokumentacion, pranë Autoritetit kontraktues, ku ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm para hapjes së tenderit. AKK gjithashtu ka organizuar edhe një takim para hapjes së këtij tenderi me zyrtarin kryesor të prokurimit të Autoritetit kontraktues, ku e ka vënë në dijeni të njëjtin se Specifikimet teknike të përgatitura për këtë kontratë nuk janë konform natyrës së këtyre shërbimeve, mirëpo përkundër kësaj i njëjti nuk është pajtuar me gjetjet e Agjencisë.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion, konstaton se Autoriteti kontraktues ka paraparë në dosjen e tenderit tek pjesa përshkrimi i çmimeve, sasinë e faqeve që do të përkthehen, ndërsa si njësi matëse çmimin për njësi për faqe, ndërsa AKK konsideron se çmimi për njësi duhet të jetë çmimi për njësi për fjalë e jo për faqe siç ka paraparë Autoriteti.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes edhe dosjen e tenderit vëren se Autoriteti kontraktues ka paraparë kontratë publike me kohëzgjatje prej 12 muajsh duke përdorur dosjen e tenderit - shërbime procedurë e hapur. Agjencia konsideron se Autoriteti kontraktues do duhej që në dosjen e tenderit të parashihte krijimin e kontratës publike kornizë dhe ta përdorte dosjen e tenderit adekuate të aprovuar nga KRPP për kontratën kornizë - shërbime procedurë e hapur siç parashihet për shërbimet e tilla.

Me datë 18.12.2015, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim pran Autoritetit Kontraktues të cilin e ka njoftuar Agjencia do të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar faktet si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 7 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 3 OE.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se nga 3 ofertat e pranuar për këtë tender, vetëm njëra prej tyre është ofertë e përgjegjshme, andaj në mungesë të dy ofertave të përgjegjshme i njëjti ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në raportin e vlerësimit të datës 15.01.2015 i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues dhe Zyrtari kryesor i prokurimit, Agjencia ka vërejtur se **njëri nga**

Operatorët ekonomik është bërë i përgjegjshëm, ani pse Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertës së këtij Operatori ekonomik kishte konstatuar se nuk ka përmbushur kërkesën tek rubrika Kapaciteti teknik ose profesional ku janë kërkuar 3 përkthyes të licencuar. Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se vetëm njëra nga ofertat e dorëzuara për këtë kontratë është e përgjegjshme dhe jo dy siç është përshkruar në raportin e vlerësimit të tenderëve.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, Komisioni vlerësues ka konstatuar dhe është pajtur se specifikimi teknik i hartuar i cili është pjesë e dosjes së tenderit, do të vështirësojë implementimin e kontratës, pasi që është paraparë që pagesa të bëhet në bazë të faqeve të përkthyer e cila do t'i mundësonte Operatorëve që edhe nëse përkthejnë gjysmë faqe të njëjtën ta llogarisin në faqe të plotë për pagesë. Bazuar në këto arsye komisioni rekomandon zyrën e prokurimit që ketë aktivitet të prokurimit ta anuloj dhe të njëjtin ta ri-tenderoj duke ndryshuar specifikimin teknik për pagesë nga faqe e përkthyer në fjalë të përkthyer.

Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i kushtoj vëmendjen e duhur hartimit të specifikimeve teknike me rastin e ri-tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit duke precizuar saktë madhësinë e letrës, margjinat, tipin dhe madhësinë e fontit, pastaj të precizoj se logot, fotografitë, nuk llogariten si fjalë të përkthyer e detajet tjera që parashihen për shërbimet e përkthimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike dhe me nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga Autoriteti kontraktues që në rast të ri-tenderimit të këtij aktiviteti të prokurimit të veprojnë konform Legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe që të mos i përsëris praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !